

Demokracia përballë ideologjisë, populizmit dhe tiranisë së shumicës

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË FILOZOFI POLITIKE

nga

OMER KOSUMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
FILOZOFI POLITIKE

Prishtinë

Korrik, 2026

Demokracia përballë ideologjisë, populizmit dhe tiranisë së shumicës

Mentor: Prof. Asst. Dr. Valon Leci

Kandidat: Omer Kosumi

Punimi “*Demokracia përballë ideologjisë, populizmit dhe tiranisë së shumicës*”, mbrohet nga Omer Kosumi për marrjen e gradës Master i Arteve në Filozofi Politike.

REZYME

Kudo dhe kurdo që venitet kuptimi mbi demokracinë, vlerat e barazisë, lirisë dhe të drejtësisë do të minimizohen, si dhe kurdo që zbehen konceptet e lirisë, barazisë dhe drejtësisë, minimizohet vlera e demokracisë. Rrjedhimisht, demokracia përbën një variabël të dyfishtë: është mekanizëm (mjet) në shërbim të qëllimeve përfundimtare politike dhe morale; dhe është qëllimi i lartë politik apo moral që mëtohet përmes mekanizmave të tjerë. Në këtë kuptim, koncepti i demokracisë është dinamik dhe i kushtëzuar nga marrëdhëniet komplekse ndërmjet vlerave të larta individuale dhe kolektive, të cilat e kushtëzojnë dhe determinojnë njëra-tjetrën.

Demokracia nuk është vetëm një koncept që i atribuohet hapësirës politike: marrëdhënieve ndër-partiake; pushtetit të institucioneve dhe rolit të zgjedhjeve, por në thelbin e saj gërshetohet një rol filozofik: emancipimi dhe zhvillimi i kapitalit intelektual dhe kulturor. Në këtë kuptim, demokracia nuk është vetëm manifestim dhe reflektim i mendjes së emancipuar, por demokracia ofron konditat e emancipimit të mendjes njerëzore: ajo zhvillon hapësirën e dialektikës mbi premisën e kundërthënies.

Pavarësisht vlerave metafizike, demokracia rrezikohet nga keqkuptimi dhe keqinterpretimi normativ, si dhe nga ideologjia, populizmi dhe tirania e shumicës. Për më tepër, ajo se çfarë e kërcënon demokracinë është mungesa e kapitalit intelektual që manifestohet në pushtetin e turmave: varfëria intelektuale si përligje e pushtetit politik dhe moral.

Në pjesën e parë të punimit trajtohen dimensionet themelore teorike dhe filozofike të demokracisë, duke filluar nga determinizmi i saj i dyanshëm, përkatësisht demokracia si mekanizëm emancipues dhe njëkohësisht emancipimi i demokracisë nga mekanizma dhe vlera të tjera. Në këtë kontekst, shqyrtohen pyetjet esenciale politike dhe filozofike mbi kuptimin e

pushtetit, identitetin e popullit si bartës i sovranitetit, si dhe objektin mbi të cilin ushtrohet pushteti popullor. Më tej, trajtohet përkufizimi i demokracisë në këndvështrimin normativ dhe empirik, duke analizuar dallimin ndërmjet demokracisë ideale dhe demokracisë empirike - institucionale. Një vëmendje e veçantë i kushtohet demokracisë përfaqësuese, reduktimit të demokracisë në procesin zgjedhor, si dhe monopolizimit të vendimmarrjes nga elitat politike.

Në pjesën e dytë të punimit trajtohen konceptet e ideologjisë dhe populizmit, duke analizuar përkufizimet dhe interpretimet kryesore teorike mbi këto dukuri politike e shoqërore. Fillimisht shqyrtohet kuptimi i ideologjisë, format dhe funksionet e saj, si dhe mënyrat në të cilat ajo shndërrohet në instrument propagande, manipulimi dhe tjetërsimi të individit. Më pas, analizohet fenomeni i populizmit, përkufizimet teorike mbi të dhe mënyra se si ai ndërton antagonizmin ndërmjet “popullit” dhe “elitës”. Në këtë aspekt, populizmi trajtohet si një instrument politik me prirje totalitare, i cili synon homogjenitetin e shoqërisë, delegjitimimin e pluralizmit dhe përqendrimin e pushtetit në emër të vullnetit absolut të popullit. Në fund të kësaj pjese, shqyrtohet raporti kompleks ndërmjet demokracisë, ideologjisë dhe populizmit, si dhe ndikimi i tyre në funksionalitetin e demokracisë.

Në pjesën e tretë të punimit trajtohet liria - si njëra ndër vlerat themelore mbi të cilat ndërtohet demokracia, si dhe fenomeni i tiranisë së shumicës - si një prej paradokseve të saj. Analiza fokusohet në faktin se demokratizimi institucional nuk nënkupton domosdoshmërisht demokratizimin shoqëror, duke nënkuptuar që, edhe pse individ mund të çlirohet nga autoriteti represiv institucional dhe nga pushteti i drejtpërdrejtë i forcës, ai mbetet i ekspozuar ndaj formave të dominimit shoqëror dhe simbolik. Në këtë kuptim, individ ndodhet nën ndikimin e një pushteti simbolik që vepron përmes normave, vlerave, moralit kolektiv dhe pritjeve shoqërore, duke prodhuar një gjendje të tjetërsimit dhe nënshtrimit që manifestohet përmes tiranisë së shumicës. Në një realitet të tillë, individ gëzon liri përball autoritetit dhe pushtetit të forcës nga institucionet, por është i rrëmbyer nga pushteti simbolik i shoqërisë.

Ky punim trajton demokracinë si një fenomen filozofik, politik dhe shoqëror të ndërtuar mbi marrëdhënien dialektike ndërmjet lirisë, barazisë dhe drejtësisë. Problemi kryesor që shtjellohet lidhet me paradokset e brendshme të demokracisë: ajo paraqitet njëkohësisht si mekanizëm emancipues dhe si formë sundimi që legjitimohet nga masa, shpesh e karakterizuar nga mungesa e emancipimit kritik dhe intelektual. Punimi analizon raportin ambivalent të demokracisë me ideologjinë dhe populizmin, të cilat shfaqen si instrumente të kohezionit politik, por edhe si kërcënime ndaj pluralizmit dhe autonomisë së mendimit.

Metodologjia e përdorur në këtë punim mbështetet në një qasje analitike dhe kritike, e cila synon trajtimin teorik dhe filozofik mbi demokracinë, ideologjinë, populizmin dhe tiraninë e shumicës. Përmes qasjeje analitike, konceptet si demokracia, pushteti, ideologjia, populizmi dhe liria trajtohen jo vetëm në kuptimin e tyre formal dhe institucional, por edhe në dimensionin e tyre filozofik, simbolik dhe shoqëror. Ndërsa, përmes qasjes kritike mëtohet trajtimi i paradokseve të demokracisë dhe pushtetit të ideologjisë dhe populizmit.

Punimi është ndërtuar mbi bazën e studimit të literaturës shkencore relevante, duke përfshirë libra, artikuj shkencorë, studime akademike dhe burime teorike të autorëve të ndryshëm nga fusha e filozofisë politike. Rezultatet e punimit tregojnë se demokracia nuk mund të reduktohet vetëm në procesin zgjedhor apo përfaqësim formal, pasi demokratizimi institucional nuk nënkupton domosdoshmërisht emancipimin individual apo kolektiv në raport me pushtetin.